

# **VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.**

**Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më  
31 dhjetor 2022**

**(Shoqëruar me raportin e audituesit të pavarur)**



Ernst & Young Ekspertë Kontabël të Autorizuar Tel: +35542419575  
Dega në Shqipëri ey.com  
NIUS: K619110121  
Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, kati 6  
1001, Tiranë, Shqipëri

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Për Aksionerin e VIG Services Shqipëri sh.p.k

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të VIG Services Shqipëri Sh.p.k ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2022, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2022, dhe rezultatin e saj financiar dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").

#### Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.


Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin e VIG Services Shqipëri Sh.p.k, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Dega në Shqipëri

  
7 korrik 2023  
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel  
Auditues Ligjor



## **PËRMBAJTJA**

<b>RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR.....</b>	<b>1</b>
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....</b>	<b>1</b>
<b>PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIME.....</b>	<b>2</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL.....</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE .....</b>	<b>4</b>
<b>1. NJËSIA RAPORTUESE .....</b>	<b>5</b>
<b>2. BAZA E PËRGATITJES .....</b>	<b>5</b>
<b>3. POLITIKAT KONTABËL .....</b>	<b>6</b>
<b>4. MJETE MONETARE DHE TË TJERË EKUIVALENTË.....</b>	<b>10</b>
<b>5. LLOGARITË E ARKËTUESHME .....</b>	<b>10</b>
<b>6. PAJISJE.....</b>	<b>11</b>
<b>7. AKTIVET JO-MATERIALE .....</b>	<b>12</b>
<b>8. AKTIVE TE TJERA .....</b>	<b>12</b>
<b>9. LLOGARITË E PAGUESHME.....</b>	<b>12</b>
<b>10. PROVIZIONE.....</b>	<b>13</b>
<b>11. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA .....</b>	<b>13</b>
<b>12. KAPITALI AKSIONAR .....</b>	<b>13</b>
<b>13. TË ARDHURAT .....</b>	<b>13</b>
<b>14. SHPENZIME PERSONELI .....</b>	<b>14</b>
<b>15. SHPENZIME ADMINISTRATIVE.....</b>	<b>14</b>
<b>16. SHPENZIME PËR TATIM FITIMIN.....</b>	<b>15</b>
<b>17. PALËT E LIDHURA.....</b>	<b>15</b>
<b>18. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA .....</b>	<b>16</b>
<b>19. ÇËSHTJE LIGJORE .....</b>	<b>16</b>
<b>20. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT .....</b>	<b>16</b>


**VIG SERVICE SHQIPERI Sh.p.k.**  
**Pasqyra e pozicionit financiar 31 Dhjetor 2022**

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)


<b>AKTIVET</b>	<b>Shënime</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>
<b>Aktivitet afatshkurtra:</b>			
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	4	19,794,179	15,108,564
Kërkesa të arkëtueshme	5	7,206,579	11,163,273
<b>Aktivitet afatgjata:</b>			
Paisje	6	17,076,419	16,202,990
Aktive afatgjata jo-materiale	7	16,719,337	11,458,275
Të arkëtueshme të tjera	8	3,276,440	4,322,727
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>64,072,954</b>	<b>58,255,829</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>Detyrimet:</b>			
Të pagueshme ndaj furnitorëve	9	4,230,667	9,952,806
Provizione	10	5,123,572	6,104,662
Të pagueshme të tjera	11	1,426,289	1,718,328
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>10,780,539</b>	<b>17,775,796</b>
<b>Kapitali:</b>			
Kapitali aksionar	12	42,339,750	30,046,758
Fitimet e paspërndara		10,952,666	10,433,275
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>53,292,416</b>	<b>40,480,033</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>64,072,954</b>	<b>58,255,829</b>

Bilanci duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë autorizuar nga Drejtimi i VIG Service Sh.p.k. më \_\_\_\_\_ 2023 dhe janë firmosur nga:

  
 Ilir Elmazi  
 Administrator



  
 Ardita Gjika  
 Accountant

**VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.****Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

	<i>Shënime</i>	<b>2022</b>	<b>2021</b>
Të ardhurat	13	58,886,387	60,611,608
Te ardhura te tjera		152,973	
Shpenzimet e personelit	14	(13,659,282)	(14,215,640)
Shpenzime administrative	15	(36,302,247)	(37,416,194)
Amortizimet dhe zhvlerësimet	6,7	(8,186,998)	(8,670,036)
<b>Fitim nga veprimtaria kryesore</b>		<b>890,833</b>	<b>309,738</b>
Humbje nga kursi i këmbimit		(191,031)	(190,808)
<b>Shpenzimet financiare neto</b>		<b>(191,031)</b>	<b>(190,808)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>699,802</b>	<b>118,930</b>
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	16	(180,411)	(238,573)
<b>Fitimi/ (humbja) për vitin</b>		<b>519,391</b>	<b>(119,643)</b>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**VIG SERVICES SHQIPERI sh.p.k.**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Fitimi i pashpërndarë</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2021</b>	<b>30,046,758</b>	<b>10,552,918</b>	<b>40,599,676</b>
Humbja neto per periudhën	-	(119,643)	(119,643)
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>30,046,758</b>	<b>10,433,275</b>	<b>40,480,033</b>
Fitimi neto për vitin	-	519,391	519,391
Rritje ne kapitalin aksionar	12,292,992	-	12,292,992
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>42,339,750</b>	<b>10,952,666</b>	<b>53,292,416</b>

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**VIG SERVICES SHQIPERI sh.p.k.****Pasqyra e fluksit të parasë***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

	<i>Shënime</i>	<i>2022</i>	<i>2021</i>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet operacionale</b>			
Fitimi perpara tatimit		699,802	118,930
Amortizimi dhe zhvlersimi	6,7	8,186,998	8,670,036
Vlera kontabel neto e aktiveve të shitura (Rimarrja)/ rritja e provizioneve	6,7	151,073	-
Te ardhura të tjera nga policat e sigurimit të perfutuara falas		(187,156)	311,356
		(152,973)	-
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operacionale:</i>			
Rritja/ (ulja) në llogaritë e arkëtueshme		3,956,694	(296,750)
Rritja/ (ulja) në te arketueshmet e tjera (Rritja)/ ulja në llogaritë e pagueshme		865,876	(1,375,998)
Ulja e detyrimeve të tjera		(5,722,129)	6,960,721
		(933,000)	(7,253,578)
<b>Flukset monetare të përdorura nga aktivitetet operacionale</b>		<b>6,865,185</b>	<b>7,134,718</b>
Tatimi mbi fitimin i paguar		-	-
<b>Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operacionale</b>		<b>6,865,185</b>	<b>7,134,718</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet investuese</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	6	(5,186,126)	(2,311,282)
Blerje e aktiveve jo-materiale	7	(9,286,436)	-
<b>Mjete monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese</b>		<b>(14,472,562)</b>	<b>(2,311,282)</b>
<b>Aktivitetet financiare</b>			
Kapital i kontribuar nga aksioneret		12,292,992	-
<b>Mjete monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financiare</b>		<b>12,292,992</b>	<b>-</b>
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		4,685,615	4,823,435
Mjete monetare dhe ekuivalentë në 1 janar	4	<b>15,108,564</b>	<b>10,285,129</b>
<b>Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë më 31 dhjetor</b>	4	<b>19,794,179</b>	<b>15,108,564</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



# VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

### 1. Njësia raportuese

VIG Service sh.p.k. (“Shoqëria”) u themelua në Shqipëri më 22 dhjetor 2011 në Tiranë, Shqipëri, me qëllim për të vepruar si një qendër shërbimesh e përbashkët për ofrimin e shërbimeve manaxheriale entiteteve të Vienna Insurance Group (“VIG”) që operojnë në Shqipëri.

Adresa e selisë kryesore të biznesit është Rr. “Pjeter Bogdani”, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria Mëmë me e fundit është Vienna Insurance Group AG e vendosur në Vien, Austri.

Më 31 dhjetor 2022, Shoqëria ka pasur 5 punonjës (2021: 5) dhe aksionerët e Shoqërisë dhe kuotat e kapitalit respektivë janë si më poshtë:

	Në %	
	2022	2021
Sigma InterAlbanian Sha	50.00%	50.00%
Intersig Sha	50.00%	50.00%
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

### 2. Baza e përgatitjes

#### a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

#### b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### c) Monedha funksionale dhe e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në LEK, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë, monedha kryesore e mejdisit ekonomik në Republikën e Shqipërisë

#### d) Parimi i vijmësisë

Pasqyrat financiare nga ana e drejtuesve të shoqërisë janë përgatitur në bazë të parimit të vijmësisë, i cili merr në konsideratë vazhdimësinë e aktivitetit në të ardhmen. Bazuar në këtë gjykim drejtimi konsideron pozicionin financiar të shoqërisë dhe pritshmërinë për të ardhmen në aktivitet me përfitime. Shoqëria nuk është në konkurrencë me shoqëri të tjera në treg.

Bazuar në strategjinë dhe parashikimin afatmesëm drejtimi beson që rezultati negativ i vitit aktual pritet të mbulohet me fitimet e viteve pasardhëse.

#### e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimet dhe supozimet e tyre që ndikojnë në procesin e zbatimit të politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurive dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale.

# VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël

#### (a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Aktivitet dhe detyrimet e jo-monetare në monedhë të huaj të cilat janë matur me vlerën e drejtë konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit të datës në të cilën u përcaktua vlera e drejtë. Aktivitet dhe detyrimet e tjera jo-monetare në monedhë të huaj të cilat janë matur me kosto historike konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit të datës në të cilën ka ndodhur transaksioni. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit me 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2022	2021
Euro/ALL	114.23	120.76
USD/ ALL	107.05	106.54

#### (b) Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke shtuar, për instrumentat e mbajtur jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur Shoqëria transferon aktivitet financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitet. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë*

Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllimin e përgatitjes së pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre maten me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiarë

#### *Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme në hyrje njihen me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

#### *Llogaritë e pagueshme dhe të tjerë të pagueshëm*

Llogaritë e pagueshme dhe të tjerë të pagueshëm, në hyrje njihen me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar

# VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (b) Instrumentat financiarë (vazhdim)

*Të tjera*

Instrumenta të tjerë financiarë jo derivativë janë matur me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në shënimin 3.i.

#### (c) Kapitali Aksionar

Kapitali aksionar I Shoqërisë matet me vlerë nominale.

#### (d) Pajisje

##### 1. Njohja dhe vlerësimi

Zërat e aktiveve afatgjata materiale vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimet (nëse ka).

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse ka), çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Në rastet kur pjesë të një zëri të pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (komponentët më të mëdhenj) të pajisjeve.

##### 2. Kostot e mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të pajisjeve njihet në vlerën e mbetur të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese dhe kosto e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme.

Kostot e mirëmbajtjes së përditshme të pajisjeve njihen si humbje apo fitime në periudhën që ato kryhen.

##### 3. Amortizimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe llogaritet me metodën e vlerës së mbetur. Aktivet fikse të parapaguara nuk zhvlerësohen.

Normat e zhvlerësimit për periudhën korrente dhe ato krahasuese janë si më poshtë:

• Automjete	20%
• Pajisje zyre dhe mobilje	20%
• Kompjuterat dhe Serverat	25%
• Të tjera	20%

Normat e zhvlerësimit dhe vlerat e mbetura të aktiveve afatgjata materiale, kur janë të rëndësishme, rivlerësohen në datën e raportimit.

#### (e) Aktivët jo-materiale

Aktivët jo-materiale të 7-atesa prej Shoqërisë njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimet (nëse ka). Shpenzimet e mëtejshme kapitalizohen vetëm nëse rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të mishëruara në aktivin specifik të cilit i referohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në humbje dhe fitime në periudhën kur ndodhin. Amortizimi njihet në humbje ose fitime mbi bazën e vlerës së mbetur me një normë 25% në vit, duke filluar që prej datës në të cilën aktivet kanë qënë të gatshme për përdorim.

# **VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.**

## **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **(f) Zhvlerësimi**

##### *(i) Aktivet financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parashikuara të aktivit.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën fillestare efektive të interesit.

Aktivitet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera të mbetura financiare, si për shembull të arkëtueshmet, vlerësohen kolektivisht, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *(ii) Aktivet jo-financiare*

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo shuma e parave që ai gjeneron tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **(g) Shpenzimet për personelin**

##### *Kontribute për Sigurimet Shoqërore*

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, sipas legjislacionit në fuqi, Shoqëria kryen pagesa për të kontribuar në pensionet e detyrueshme, si për llogari të saj ashtu edhe për llogari të punonjësve të saj. Kostot që i takojnë Shoqërisë paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën në të cilën ato ndodhin.

##### *Lejet e zakonshme të paguara*

Shoqëria njih si detyrim shumat e plota të kostove të vlerësuar lidhur me lejet vjetore që pritet ti paguhen punonjësve përkundrejt shërbimit të tyre për periudhën e plotë raportuese.

#### **(h) Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim të tanishëm ligjor apo konstruktiv, detyrim i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe që për shlyerjen e tij mund të jetë e nevojshme dalja e burimeve ekonomike. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të pritshme të parasë përmes një norme para tatimit që reflekton vlerësimin korrent të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të lidhura me detyrimin në fjalë.

# VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

### 3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (i) Njohja e të ardhurave

Nëse rezultati i një transaksioni që lidhet me ofrimin e një shërbimi mund të matet në mënyrë të besueshme, e ardhura e lidhur me këtë transaksion do të njihet në masën që i korrespondon fazës së perfundimit të transaksionit në datën e raportimit.

#### (j) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat prej fondeve të investuara në depozitat bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit. E ardhura nga interesat njihet ndersa fitohet duke aplikuar metodën e normës efektive të interesit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave prej huave dhe humbjet nga kurset e këmbimit dhe matet duke aplikuar metodën e normës efektive të interesit. Të gjitha kostot e huamarrjes, nëse ka, do të njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### (k) Shpenzimet për tatim fitimin

Shpenzimi për tatim fitimin është tatimin e periudhës i cili njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës përbën tatimin e pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme, duke përdorur normat tatimore të miratuara për periudhën.

Tatimi mbi të ardhurat e shtyra sigurohet duke përdorur metodën e detyrimeve të pasqyrës së pozicionit financiar për mbartjen e humbjeve tatimore, nëse ka, dhe dallimet e përkohshme që lindin midis bazave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe shumave të tyre mbartëse për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin e njohjes fillestare, tatimi i shtyrë nuk regjistrohen për diferencë të përkohshme mbi njohjen fillestare të një aktivi ose detyrimi në një transaksion tjetër përveç një kombinimi biznesi nëse transaksioni, kur është regjistruar fillimisht, nuk ndikon as në kontabilitet, as në fitim të tatueshëm. Gjendja e tatimit të shtyrë matet me normat tatimore të miratuara në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur diferencat e përkohshme do të rimerren ose humbja e taksave do të rritet. Aktivi tatimor i shtyrë për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet e tatimit të shtyre përpara janë regjistruar vetëm në atë masë sa ka të ngjarë që fitimi i ardhshëm i tatueshëm të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoren zbritjet.

**Pozita të pasigurta tatimore.** Pozicionet e pasigurta tatimore të shoqërisë rivlerësohen nga menaxhimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet janë regjistruar për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat që përcaktohen nga menaxhimi si më të mundshme se të mos rezultojnë në taksë shtesë të vëna në qoftë se pozitat do të sfidoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar deri në fund të periudhës raportuese, dhe në çdo gjykatë të njohur apo vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për gjokat, interesat dhe taksat përveç të ardhurave njihen bazuar në vlerësimin më të mirë nga menaxhimi për të zgjidhur detyrimet në fund të periudhës raportuese.

**Tatimi mbi vlerën e shtuar.** Tatimi mbi vlerën e shtuar lidhur me shitjet është i pagueshëm për autoritetet tatimore në fillim të (a) mbledhjes së të ardhurave nga klientët ose b) dorëzimit të mallrave ose shërbimeve për klientët. TVSH-ja hyrëse është përgjithësisht e rikuperueshme kundrejt TVSH-së në dalje pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet e taksave lejojnë zgjidhjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja lidhur me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e pozicionit financiar në baza bruto dhe mbahet vecmas në aktiv dhe pasiv. Kur është bërë provizioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, humbja nga zhvlerësimi është njohur në vlerën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

## VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

#### 4. Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë janë paraqitur sipas monedhes (perkthyer ne Lek):

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Para në dorë	-	88,084
Llogari rrjedhëse	19,794,179	15,020,480
LEK	19,243,010	14,881,189
EUR	551,169	139,291
<b>Totali</b>	<b>19,794,179</b>	<b>15,108,564</b>

#### 5. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme përbëhen nga:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
SigmaInteralbanian VIG Sh.a	3,769,538	6,211,681
Intersig VIG Sh.a	3,437,041	4,951,592
<b>Totali</b>	<b>7,206,579</b>	<b>11,163,273</b>

**VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

**6. Pajisje**

Pajisjet përbëhen nga:

	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje	Kompjuterë dhe Servera	Totali
<i>Kosto</i>				
<b>Më 1 janar 2021</b>	<b>9,772,619</b>	<b>7,747,983</b>	<b>31,572,280</b>	<b>49,092,882</b>
Shtesat	1,926,762	311,207	73,314	2,311,283
Pakësimet	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>11,699,381</b>	<b>8,059,190</b>	<b>31,645,594</b>	<b>51,404,165</b>
Shtesat	3,630,100	287,526	1,268,500	5,186,126
Pakësimet	(1,329,406)	-	-	(1,329,406)
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>14,000,075</b>	<b>8,346,716</b>	<b>32,914,094</b>	<b>55,260,885</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
<b>Më 1 janar 2021</b>	<b>6,813,672</b>	<b>3,909,929</b>	<b>19,626,963</b>	<b>30,350,564</b>
Zhvlerësimi i periudhes	720,240	842,003	3,288,368	4,850,611
Paksime	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>7,533,912</b>	<b>4,751,932</b>	<b>22,915,331</b>	<b>35,201,175</b>
Zhvlerësimi i periudhes	1,076,813	708,032	2,376,779	4,161,624
Paksime	(1,178,333)	-	-	(1,178,333)
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>7,432,392</b>	<b>5,459,964</b>	<b>25,292,110</b>	<b>38,184,466</b>
<i>Vlera kontabël neto</i>				
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>4,165,469</b>	<b>3,307,258</b>	<b>8,730,263</b>	<b>16,202,990</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>6,567,683</b>	<b>2,886,752</b>	<b>7,621,984</b>	<b>17,076,419</b>

**VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

**7. Aktive afatgjata jo-materiale**

Aktivitet afatgjata jo-materiale përbëhen nga:

	<b>Program kompjuterik</b>
<i>Kosto</i>	
<b>Më 1 janar 2021</b>	<b>25,756,332</b>
Shtesa	-
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>25,756,332</b>
Shtesa	9,286,436
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>35,042,768</b>
<i>Amortizim i akumuluar</i>	
<b>Më 1 Janar 2021</b>	<b>10,478,632</b>
Amortizimi i periudhes	3,819,425
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>14,298,057</b>
Amortizimi i periudhes	4,025,374
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>18,323,431</b>
<i>Vlera kontabël neto</i>	
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>11,458,275</b>
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>16,719,337</b>

**8. Te arketueshme te tjera**

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Parapagime	2,710,836	3,656,427
Tatim ne burim	259,221	259,221
Parapagim tatim fitimi	226,668	407,079
Aktive te tjera	79,715	-
<b>Total</b>	<b>3,276,440</b>	<b>4,322,727</b>

Paradhëniet janë shuma të dhëna punonjesve per shpenzime gjate udhetimeve. Këto shuma konsiderohen të arkëtueshme nga shoqëria.

**9. Te pagueshme ndaj furnitoreve**

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Vienna Insurance Group AG	1,071,178	3,467,922
Insurance Makedonija	1,402,869	2,928,430
Sigma Interbalkanian VIG Sh.a	-	1,469,491
Të tjera	1,756,630	2,086,963
<b>Total</b>	<b>4,230,677</b>	<b>9,952,806</b>



## VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

#### 10. Provizione

Provizionet per 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 përbehen nga:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Provizione per ceshtje gjyqesore	5,123,572	6,104,662
<b>Total</b>	<b>5,123,572</b>	<b>6,104,662</b>

Me 31 dhjetor 2022, Shoqëria është subjekt ne 3 çështje gjyqësore me punonjës të larguar. Bazuar ne vendimin e shkallës së pare të gjykatës shoqëria ka bërë provizione në shumën e 5,123,572 ALL (2021: 6,104,662).

#### 11. Të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme të tjera përbehen nga:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
TVSH e pagueshme	1,037,188	1,406,671
Sigurime shoqërore	173,071	118,866
Detyrime ndaj personelit	216,030	192,791
Tatimi mbi të ardhurat personale	-	-
<b>Totali</b>	<b>1,426,289</b>	<b>1,718,328</b>

Llogaritë e pagueshme të tjera përfshijnë kryesisht detyrime shtetërore.

#### 12. Kapitali aksionar

Më poshtë jepet përmbledhja e kuotave të kapitalit në fund të çdo viti, vlera ne LEK 42,339,750 dhe (2021: 30,046,758 dhe 15,023 per aksion).

	Kapitali në %		(Në LEK)	
	2022	2021	2022	2021
Sigma Interalbaniian VIG Sha	50.00	50.00	21,169,875	15,023,379
Intersig VIG Sha	50.00	50.00	21,169,875	15,023,379
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>	<b>42,339,750</b>	<b>30,046,758</b>

#### 13. Të ardhurat

Balanca përbehet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Sigma Interalbaniian VIG Sh.a	33,787,397	34,358,111
Intersig Sh.a	25,098,945	26,062,634
Te tjera	45	190,863
<b>Total</b>	<b>58,886,387</b>	<b>60,611,608</b>

## VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

#### 13. Të ardhurat (vazhdim)

Në përputhje me marrëveshjen e shërbimit të nënshkruar midis Shoqërisë (“Ofruesi i Shërbimit”) dhe aksionarëve të saj (“Përfituesit e Shërbimit”) do të ofrohen shërbimet e mëposhtme:

- Menaxhimi i dëmeve;
- Shërbime IT –je dhe
- Shërbime financiare dhe kontabiliteti.

Për shërbimet e menaxhimit të dëmeve Ofruesi i Shërbimit do të faturojë një tarifë mujore te bazuar mbi numrin e dosjeve, ndërsa për shërbimet e financës faturimi bazohet mbi primin e shkruar bruto të seciles shoqëri, për shërbimet e IT-së tarifa mujore llogaritet bazuar mbi numrin e përdoruesve të kompjuterave të cdo shoqërie të cdo muaji. Nurmi i përdoruesve në fund të 2022 për Sigmainteralbanian 178 dhe Intersig 146 (2021: Sigmainteralbanian 200, Intersig 162)

#### 14. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Pagat	12,639,098	13,133,208
Kontribute për sigurimet shoqërore	1,020,184	1,082,432
<b>Totali</b>	<b>13,659,282</b>	<b>14,215,640</b>

#### 15. Shpenzime administrative

Balanca përbëhet lëvizjet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime IT	11,603,354	13,906,458
Qera	10,008,810	10,294,698
Shpenzime fikse	4,091,881	2,720,878
Shpenzime mirembajtje	3,196,694	2,868,234
Utilitete (Energji dhe ujë)	1,952,856	1,396,999
Karburant	1,572,980	1,199,000
Konsulenca	972,000	1,418,040
Shpenzime telefoni dhe poste	765,640	591,320
Shpenzime të tjera	626,863	991,362
Shërbime sigurie	597,500	696,000
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	584,219	118,629
Auditim	414,906	392,608
Taksa dhe kontribute	101,700	510,612
Zhvlersime për të arketueshme të tjera	(187,156)	311,356
<b>Totali</b>	<b>36,302,247</b>	<b>37,416,194</b>

## VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

#### 15. Shpenzime administrative (vazhdim)

Tek zëri konsulence janë përfshirë kosto nga shërbimet e auditimit për departamentin e IT.

Tarifa e auditimit për vitin aktual paraqitet në zërin e Konsulencës së Jashtme dhe është në vlerën 342,690 lekë.

Mirëmbajtja dhe riparimi janë rritur për shkak të zyrës së re e cila është marrë me qira në gusht.

Shpenzimet e tjera përfshijnë kryesisht kostot e perfaqsimit dhe shpenzimet për zyrën (uji, kafe, detergjent, etj)

Ekspertiza e jashtme përfshin kosto e ndërmarra nga shoqëria për ekspertet e trajtimit të dëmeve.

#### 16. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Pasqyra më poshtë paraqet një llogaritje të fitimit të tatueshëm dhe ndryshimit në tatim:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fitimi para tatimit	699,802	118,930
Humbje e mbartur	(119,643)	-
Shpenzime të pazbritshme	622,584	1,471,553
Fitim i tatueshëm	<b>1,202,743</b>	<b>1,590,483</b>
<b>Shpenzimi për tatim fitimin @ 15% (2021:15%)</b>	<b>180,411</b>	<b>238,573</b>

#### 17. Palët e lidhura

Palët e lidhura për Shoqërinë përbëhen nga shoqëria mëmë përfundimtare dhe aksionarët e saj. Më poshtë jepen palët e lidhura dhe lloji i lidhjes:

- Intersig VIG Sha – aksionar
- SigmaInteralbanian VIG Sha – aksionar
- Vienna Insurance Group AG – shoqëri mëmë përfundimtare

##### Aksioner

Mes shoqërisë dhe aksionerëve të saj është lidhur një kontratë për shërbimet e ofruara:

- Trajtim dëme
- Shërbime IT
- Raportim financiar dhe shërbime kontabiliteti

Për trajtimin e dëmeve, shërbimi mujor llogaritet duke marrë parasysh numrin e dëmeve të trajtuara. Për shërbimet financiare, llogaritja bëhet mbi bazën e primeve bruto të shkuara në muaj për çdo klient. Për shërbimet e IT, llogaritja e kostos mujore bëhet në bazë të numrit të përdoruesve për secilin shoqëri, çdo muaj.

##### Shoqëria mëmë

Në një marrëveshje midis VIG AG dhe shoqërive (Sigma InterAlbanian VIG Sha dhe Intersig VIG Sha) që kostoja e lidhur me mirëmbajtjen e SAP do t'i faturohet Vig Services Shqiperi dhe do të ndahet midis shoqërive në pjesë të barabartë.

## VIG SERVICES SHQIPERI Sh.p.k.

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

#### 17. Palët e lidhura (vazhdim)

Shoqëria ka marrë pjesë në një sërë transaksionesh me palët e lidhura. Një përmbledhje e balancave me palët e lidhura më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 jepet si më poshtë:

	2022	2021
Të arkëtueshme/(Të pagueshme)		
Te arkëtueshme nga Intersig VIG Sh.a	3,436,606	4,951,592
Te arkëtueshme nga SigmaInteralbanian VIG Sh.a	3,769,973	6,211,681
Detyrime ndaj Insurance Makedonija	(1,405,029)	(2,928,430)
Detyrime ndaj Vienna Insurance Group AG	(1,070,953)	(3,467,922)
Detyrime ndaj Intersig VIG Sh.a	-	(1,469,491)

Një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura, pjesë e të ardhurave jepet si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
SigmaInteralbanian VIG Sh.a	33,787,397	34,358,111
Intersig Sh.a	25,098,945	26,062,634
<b>Total</b>	<b>58,886,342</b>	<b>60,420,745</b>

Një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura, pjesë e shpenzimeve jepet si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
SigmaInteralbanian VIG Sh.a	146,583	78,701
Intersig VIG Sh.a	10,075,445	10,308,040
Insurance makedonija	3,868,608	5,242,861
Vienna Insurance Group AG	3,257,987	4,836,370
<b>Totali</b>	<b>17,348,623</b>	<b>20,465,972</b>

Shpenzimet me SigmaInteralbanian VIG Sh.a lidhen me marrjen me qira të zyrave. Shpenzimet me Vienna Insurance Group AG lidhen me shërbimet e mirëmbajtjes së SAP.

#### 18. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

##### Angazhime qeraje

Shoqëria i paguan qera vjetore SigmaInteralbanian VIG Sh.a për përdorimin e zyrave të saj. Angazhimet minimale të qerasë paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Jo më vonë se një vit	2,398,830	2,535,960
<b>Total</b>	<b>2,398,830</b>	<b>2,535,960</b>

#### 19. Çështje ligjore

Shoqëria është subjekt i 2 çështjeve gjyqësore, pretendimi apo padie të ish-punonjësve më datë 31 dhjetor 2022. Janë krijuar privozione në bazë të vendimit të shkallës së parë në shumën 5,123,572 ALL (2021: 6,104,662). Shoqëria ka apeluar te dyja çështjet.

#### 20. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.